



**CIGRE** 2025  
22 - 24 Tetor 2025 | October 22 - 24, 2025

**Komiteti Nacional CIGRE Kosovë**

**Konferenca e 3-të e KN CIGRE Kosovë**

Hotel EMERALD, Prishtinë  
22 - 24 Tetor 2025

# PROGRAMI I MARKETINGUT

Lista e sponsorëve të mundshëm për Konferencën e 3-të të KN CIGRE Kosovë janë:

**Sponsor Gjeneral**

**Sponsor Platinum**

**Sponsor i Artë**

**Sponsor i Argjend**

**Sponsor i Bronztë**

**Sponsor tjerë**

**Sponsor i Hapjes Solemne dhe Koktejit të Mirëseardhjes**

**Prezantimi Teknik i Kompanive**

**Qiraja e Hapësirave Ekspozuese**

**Shpërndarja e Materialeve Promovuese**

**Reklamimi**



Për secilën prej formave të mësipërme si sponsor pjesëmarrës, secili sponsor do t'i ketë të drejtat e sponsorizuesit që është parashikuar tek pjesa e mëposhtme "Fushëveprimi i Sponsorizimit".

Të gjitha detajet e nevojshme janë dhënë në faqen e internetit [www.cigre-ks.com](http://www.cigre-ks.com)



# FUSHËVEPRIMI I SPONSORIZIMIT

## SPONSOR GJENERAL

**Sponsor Gjeneral** munden me qenë deri në tre sponsorizues(≤ 3).

Duke bërë pagesën në vlerë prej 10,000.00 €, sponsorizuesi do të merr të drejtën:

- për të paraqitur logon dhe markën në kategorinë **“Sponsor Gjeneral”**:
  - në Programin e Konferencës; në fletushkën e përmbledhjeve të abstrakteve; në USB; në Raportin përfundimtar të Konferencës, si dhe në web faqen([www.cigre-ks.com](http://www.cigre-ks.com)) e KN CIGRE Kosovë deri në fund të vitit kalendarik(2025);
- mundësi për prezantim multimedial deri në 1GB në USB-në e Konferencës;
- hapësirë ekspozuese(shtand) me sipërfaqe 12m<sup>2</sup>, të pajisur, pa pagesë;
- duke theksuar logon e kompanisë në: bannerin në hyrjen kryesore; në një vend të dukshëm në sallën plenare si dhe në ekran në fillim të punës së konferencës;
- mundësia për t’u ndarë pjesëmarrësve broshura, katalogë dhe materiale të tjera propaganduese gjatë kohës së mbajtjes së Konferencës;
- pranimin e çmimit **“Sponsor i Përgjithshëm”** gjatë ceremonisë së Hapjes Solemne;
- fjalë rasti gjatë ceremonisë së Hapjes Solemne (max. 5min.), pas pranimit të çmimit;
- kohë e rezervuar për prezantim teknik në kohëzgjatje deri 60 minuta;
- një faqe me ngjyra(e biznesit tuaj) në Programin e Konferencës dhe në Raportin e Punës;
- 8 (tetë) pagesa për pjesëmarrje në konferencë.

## SPONSOR PLATINUM

**Sponsor Platinum** munden me qenë një e më shumë sponsorizues (≥ 1).

Duke bërë pagesën në vlerë prej 8,000.00 €, sponsorizuesi do të merr të drejtën:

- për të paraqitur logon dhe markën në kategorinë **“Sponsor Platinum”**:
  - në Programin e Konferencës; në fletushkën e përmbledhjeve të abstrakteve; në USB; në Raportin përfundimtar të Konferencës, si dhe në web faqen([www.cigre-ks.com](http://www.cigre-ks.com)) e KN CIGRE Kosovë deri në fund të vitit kalendarik(2025);
- mundësi për prezantim multimedial deri në 750MB në USB-në e Konferencës;
- hapësirë ekspozuese(shtand) me sipërfaqe 9m<sup>2</sup>, të pajisur, pa pagesë;
- duke theksuar logon e kompanisë në: bannerin në hyrjen kryesore; në një vend të dukshëm në sallën plenare si dhe në ekran në fillim të punës së konferencës;
- mundësia për t’u ndarë pjesëmarrësve broshura, katalogë dhe materiale të tjera propaganduese gjatë kohës së mbajtjes së Konferencës;
- pranimin e çmimit **“Sponsor Platinum”** gjatë ceremonisë së Hapjes Solemne;
- fjalë rasti gjatë ceremonisë së Hapjes Solemne (max. 3-5min.), pas pranimit të çmimit;
- kohë e rezervuar për prezantim teknik në kohëzgjatje deri 45 minuta;
- një faqe me ngjyra(e biznesit tuaj) në Programin e Konferencës dhe në Raportin e Punës;
- 6 (gjashtë) pagesa për pjesëmarrje në konferencë.

## SPONSOR I ARTË

**Sponsor i Artë** munden me qenë një e më shumë sponsorizues ( $\geq 1$ ).

Duke bërë pagesën në vlerë prej 5,000.00 €, sponsorizuesit do të marrin të drejtën:

- për të paraqitur logon dhe markën në kategorinë **“Sponsor i Artë”**:
  - në Programin e Konferencës;
  - në fletushkën e përmbledhjeve të abstrakteve;
  - në USB;
  - në Raportin përfundimtar të Konferencës, si dhe
  - në web faqen([www.cigre-ks.com](http://www.cigre-ks.com)) e KN CIGRE Kosovë deri në fund të vitit kalendarik(2025);
- mundësi për prezantim multimedial deri në 500MB në USB-në e Konferencës;
- hapësirë ekspozuese(shtand) me sipërfaqe 6m<sup>2</sup>, të pajisur, pa pagesë;
- duke theksuar logon e kompanisë në: bannerin në hyrjen kryesore; në një vend të dukshëm në sallën plenare si dhe në ekran në fillim të punës së konferencës;
- mundësia për t’u ndarë pjesëmarrësve broshura, katalogë dhe materiale të tjera propaganduese gjatë kohës së mbajtjes së Konferencës;
- pranimin e çmimit **“Sponsor i Artë”** gjatë ceremonisë së Hapjes Solemne;
- fjalë rasti gjatë ceremonisë së Hapjes Solemne (max. 3-4min.), pas pranimit të çmimit;
- kohë e rezervuar për një prezantim teknik në kohëzgjatje deri 30 minuta;
- një faqe me ngjyra(e biznesit tuaj) në Programin e Konferencës dhe në Raportin e Punës;
- 4 (katër) pagesa për pjesëmarrje në konferencë.

## SPONSOR I ARGJEND

**Sponsor i Argjend** munden me qenë një e më shumë sponsorizues ( $\geq 1$ ).

Duke bërë pagesën në vlerë prej 2,500.00 €, ju do të merrni të drejtën:

- për të paraqitur logon dhe markën në kategorinë **“Sponsor i Argjend”**:
  - në Programin e Konferencës;
  - në fletushkën e përmbledhjeve të abstrakteve;
  - në USB;
  - në Raportin përfundimtar të Konferencës, si dhe
  - në web faqen([www.cigre-ks.com](http://www.cigre-ks.com)) e KN CIGRE Kosovë deri në fund të vitit kalendarik(2025);
- mundësi për prezantim multimedial deri në 250MB në USB e Konferencës;
- hapësirë ekspozuese(shtand) me sipërfaqe 6m<sup>2</sup>, të pajisur, pa pagesë;
- duke theksuar logon e kompanisë në: bannerin në hyrjen kryesore; në një vend të dukshëm në sallën plenare si dhe në ekran në fillim të punës së konferencës;
- mundësia për t’u ndarë pjesëmarrësve broshura, katalogë dhe materiale të tjera propaganduese gjatë kohës së mbajtjes së Konferencës;
- 2 (dy) pagesa për pjesëmarrje në konferencë.

## SPONSOR I BRONZTË

**Sponsor i Bronztë** munden me qenë një e më shumë sponsorizues ( $\geq 1$ ).

Duke bërë pagesën në vlerë prej 1,500.00 €, ju do të merrni të drejtën:

- për të paraqitur logon dhe markën në kategorinë **“Sponsor i Bronztë”**:
  - në Programin e Konferencës; në fletushkën e përmbledhjeve të abstrakteve; në USB; në Raportin përfundimtar të Konferencës, si dhe në web faqen([www.cigre-ks.com](http://www.cigre-ks.com)) e KN CIGRE Kosovë deri në fund të vitit kalendarik(2025);
- hapësirë ekspozuese(shtand) me sipërfaqe deri 6m<sup>2</sup>, të pajisur, pa pagesë;
- duke theksuar logon e kompanisë në: bannerin në hyrjen kryesore; në një vend të dukshëm në sallën plenare si dhe në ekran në fillim të punës së konferencës;
- mundësia për t’u ndarë pjesëmarrësve broshura, katalogë dhe materiale të tjera propaganduese gjatë kohës së mbajtjes së Konferencës;
- 2 (dy) pagesa për pjesëmarrje në konferencë.

## SPONSOR TJERË

**Sponsor tjerë** munden me qenë një e më shumë sponsorizues ( $\geq 1$ ).

Duke bërë pagesën në vlerë prej 1’000.00 €, ju do të merrni të drejtën:

- për të paraqitur logon dhe emrin e kompanisë në kategorinë **“Sponsor tjerë”**:
  - në Programin e Konferencës; në fletushkën e përmbledhjeve të abstrakteve; në USB; në Raportin përfundimtar të Konferencës, si dhe në web faqen([www.cigre-ks.com](http://www.cigre-ks.com)) e KN CIGRE Kosovë deri në fund të vitit kalendarik(2025);
- 1 (një) pagesë për pjesëmarrje në konferencë.

## SPONSOR I HAPJES SOLEMNE DHE KOKTEJIT TË MIRËSEARDHJES

**Sponsori i Hapjes Solemne** munden me qenë më së shumti deri tre sponsorizues ( $\leq 3$ ).

Duke bërë pagesën në vlerë prej 3,000.00 €, ju do të merrni të drejtën:

- për të paraqitur logon dhe markën në bannerin e veçantë brenda Sallës ku do të mbahet Hapja Solemne, duke treguar se jeni **“Sponsor i Hapjes Solemne të Konferencës”**;
- duke paraqitur logon dhe markën në Programin e Konferencës së 3-të të KN CIGRE Kosovë;
- do të “Falënderoheni” si përkrahës i Konferencës, i cili do të jepet në formë gojore me rastin e Hapjes Solemne të Konferencës;
- mundësi që në fund të Hapjes Solemne të përshëndetni të gjithë pjesëmarrësit dhe t’i ftoni për pjesëmarrje në Koktejin e Mirëseardhjes;
- hapësirë ekspozuese(shtand) me sipërfaqe 9m<sup>2</sup>, të pajisur, pa pagesë, me mundësi për t’u ndarë pjesëmarrësve broshura, katalogë dhe materiale të tjera propaganduese gjatë kohës së mbajtjes së Konferencës;
- 2 (dy) pagesa për pjesëmarrje në konferencë.

## PREZANTIMI TEKNIK I KOMPANIVE

Me një pagesë të tarifës fikse (sipas përshkrimit në Tabelën e mëposhtme) secila Kompani pjesëmarrëse ka të drejtë në prezantimin e kompanisë dhe programin e prodhimit për një periudhë me kohëzgjatje deri 60 minuta sipas programit të paracaktuar të organizatorit dhe të paraqitur në Programin e Konferencës.

Prezantimet teknike të kompanive do të mbahen paradite dhe pasdites. Orari i saktë i mbajtjes së prezantimeve teknike të kompanive do të publikohet në Programin e Konferencës të KN CIGRE Kosovë dhe në tabelën e njoftimeve të Konferencës.

#	Dita & Data	Salla/Lokacioni	Orari kohor	Çmimi(€)	deri
1	E Mërkurë, 22 Tetor	Hotel EMERALD	14:00 – 15:00	1,500.00 €	= 1
2	E Mërkurë, 22 Tetor	Hotel EMERALD	16:00 – 17:00	1,500.00 €	= 1
3	E Enjte, 23 Tetor	Hotel EMERALD	11:00 – 12:00	1,200.00 €	= 1
4	E Enjte, 23 Tetor	Hotel EMERALD	13:00 – 14:00	1,200.00 €	= 1
5	E Enjte, 23 Tetor	Hotel EMERALD	14:00 – 15:00	1,200.00 €	= 1
6	E Premte, 24 Tetor	Hotel EMERALD	11:00 – 12:00	1'000.00 €	= 1
7	E Premte, 24 Tetor	Hotel EMERALD	13:00 – 14:00	1'000.00 €	= 1

Ndërmarrjet, kompanitë, prodhuesit e pajisjeve dhe të tjerë të interesuar mund të rezervojnë termine kohore, hapësira shtesë apo mënyra të tjera të prezantimit të tyre (gjatë drekës, gjatë darkës, gjatë koktejeve, gjatë pauzave për kafe, etj.) sipas përshkrimit në tabelën vijuese.

#	Përshkrimi i Aktivitetit	Mundësitë për promovim gjatë aktivitetit	Çmimi(€)	deri
1	Gjatë kohës së Koktejit të Mirëseardhjes në ditën e hapjes – E Mërkurë	Vendosja e Bannerit të Kompanisë gjatë koktejit Fjalim i shkurt i përfaqësuesit të kompanisë	500.00 €	≤ 3
2	Gjatë Pauzës së kafes – E Enjte, paradite	Vendosja e Bannerit të Kompanisë gjatë pauzës	100.00 €	≤ 3
3	Gjatë drekës – E Enjte, mesditë	Vendosja e Bannerit të Kompanisë gjatë drekës	100.00 €	≤ 3
4	Gjatë Pauzës së kafes – E Enjte, pasdite	Vendosja e Bannerit të Kompanisë gjatë pauzës	100.00 €	≤ 3
5	Gjatë kohës së Performancës Artistike gjatë Gala Mbrëmjes (darkës) – E Enjte	Vendosja e Bannerit të Kompanisë gjatë Gala Mbrëmjes (darkës)	300.00 €	≤ 3
6	Gjatë Pauzës së kafes – E Premte, paradite	Vendosja e Bannerit të Kompanisë gjatë pauzës	100.00 €	≤ 3
7	Gjatë Koktejit Përmbyllës – E Premte, mesditë	Vendosja e Bannerit të Kompanisë gjatë koktejit	100.00 €	≤ 3

### Sqarim:

- Dizajni, forma, përgatitja dhe furnizimi i Bannerave të Kompanive mbete përgjegjësi e kompanive.
- Dimensionet të Bannerave të Kompanive duhet të jenë Max.: **0.6m(gjerësi) x 2.0m(gjatësi)**

## QIRAJA E HAPËSIRAVE EKSPOZUESE

Në kuadër të mbajtjes së Konferencës është e parashikuar të mbahet një ekspozitë e pajisjeve, produkteve, instrumenteve, shërbimeve dhe softuerëve në fushën e elektrikes të prodhuesve vendas dhe atyre të huaj. Ekspozuesi do të mund të marrë një hapësirë të caktuar të pajisur (me elemente si: tavolinë 2x1x1m, 2xkarrige, 2xpriza fazore, etj.) dhe një (1) pagesë për regjistrim si pjesëmarrës i Konferencës.

Çmimi i hapësirës së ekspozitës është 100€/1m<sup>2</sup>. Përmes një tarife tjetër shtesë(plus) prej 50 €/1m<sup>2</sup>, ekspozuesi do të mund të marrë një faqe (format A5) me ngjyra(kolor) në Programin e Konferencës dhe Raportin e Punës, për të paraqitur reklamën e Kompanisë së tij.

#	Përshkrimi	Lokacioni	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Çmimi njësi për m <sup>2</sup>	Çmimi sipas tipave
1	Hap. Ekspozuese, tipi 1	Hotel EMERALD	12 m <sup>2</sup> (4mx3m)	100,00 €	1,200.00 €
2	Hap. Ekspozuese, tipi 2	Hotel EMERALD	9 m <sup>2</sup> (3mx3m)	100,00 €	900.00 €
3	Hap. Ekspozuese, tipi 3	Hotel EMERALD	6 m <sup>2</sup> (2mx3m)	100,00 €	600.00 €

Planifikimi, orari dhe madhësia/dimensionet e hapësirave ekspozuese, llojet dhe çmimet e tyre do të ofrohen edhe në faqen e internetit: [www.cigre-ks.com](http://www.cigre-ks.com). Për shkak të hapësirës së kufizuar edhe numri i hapësirave ekspozuese do të jetë i kufizuar.

## SHPËRNDARJA E MATERIALEVE PROMOVUESE

Me një tarifë fikse në vlerë prej 200,00€ fitohet e drejta për shpërndarjen e broshurave, katalogëve ose ndonjë materiali tjetër promovues me të cilin Kompania do të mund t'ua dorëzoj të gjithë pjesëmarrësve të regjistruar të Konferencës së 3-të të KN CIGRE Kosovë.

Materialet Promovuese, për të cilat planifikohet t'u shpërndahen të gjithë pjesëmarrësve të regjistruar të Konferencës, fillimisht duhet të prezantohen para Këshillit Organizativ dhe pas miratimit duhet të dorëzohen më së largu deri 10 ditë para fillimit të Konferencës.

#	Përshkrimi	Çmimi(njësi)	deri
1	Shpërndarja e Materialeve Promovuese (broshura, katalogë, etj.)	200.00 €	≤ 5

## REKLAMIMI

Me një tarifë fikse në vlerë prej 500,00€/faqe fitohet e drejta për paraqitjen e reklamës së Kompanisë në një faqe(formati A5) të plotë me ngjyra në Programin e Punës dhe Raportin e Punës të Konferencës. Dizajni se si do të mund të duket profili dhe reklamimi i biznesit të Kompanisë brenda kësaj faqe të formatit A5 duhet të përgatitet nga vet Kompania përkatëse. Për subjektet që dëshirojnë të paraqesin reklamën e kompanisë së tyre në më shumë se 1 faqe (formati A5 me ngjyra), atëherë kjo është e mundur mirëpo aplikohet tarifa shtesë në vlerë prej 500,00 € për secilën faqe shtesë.

Numri i faqeve për reklamime të kompanive dhe biznesit të tyre në Programin e Punës së Konferencës është i kufizuar më së shumti deri në 10.

#	Përshkrimi	Çmimi(njësi)	deri
1	Reklamimi në Programin e Punës(faqe A5)	500.00 €	≤ 10